

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylja në lëndën penale kundër të pandehurës, B. V., për shkak të veprës penale, lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 KPRK-së, sipas aktakuzës, PP.nr. 793/16 të dt. 20.05.2016, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Rozelida Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datën 19.10.2017, shpalli publikisht, ndërsa më datë 20.10.2017, hartoi këtë.

A K T G J Y K I M

E pandehura **B. V.**, nga babai, B. dhe nëna H. e lindur M., e lindur më dt. ..., në fsh.U., K.K., me vendbanim në Gj., rr.”...” nr..., ka të kryer ..., e punësuar..., e martuar, nënë e ... fëmijëve, e gjendjes së ... ekonomike, shqiptare, shtetase e R. së Kosovës, më parë e pa dënuar, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj saj.

Ë s h t ë f a j t o r e

S e p s e, më datë ...2015, në objektin (shtëpinë e saj) në Gj., rr.”...”, e pandehura me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS-distribuími në Gjilan, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që e njëjta ka bërë një lidhje direkte jashtë pikës matëse me të cilën lidhje furnizohet me energji elektrike, dhe në këtë mënyrë energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar fare në njehsorin elektrik, me çka ka dëmtuar KEDS-in Distribuími në Gjilan, në shumë prej 206.83 Euro.

Me çka ka kryer veprën penale, lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 KPRK-së

Andaj , gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërthekësuara ligjore si dhe neneve: 4,7, 41, 49 50,51, 52, 73, 74,75,76 të KPRK-së si dhe nenit dhe 365 të KPP-ës, të pandehurës i **shqipton**,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurës B. V., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, dhe dënim me gjobë në shumë prej 150 (njëqindë e pesëdhjetë) €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e pandehura në afat verifikues prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimet kanë për t’iu revokuar.

Detyrohet e pandehura që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale, përkatësisht paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, në afat prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

E dëmtuara KEDS-i, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTH.DP në Gjilan ka paraqitur aktakuzën PP.nr. 793/16 të dt. 20.05.2016, kundër të pandehurës, B. V., për shkak të veprës penale, lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilën ka prezantuar prokurorja e shtetit Rozelida Hasani, e pandehura B. V., ndërsa përfaqësuesi i KEDS-it ka munguar.

Prokurorja e shtetit pas leximit të aktakuzës, në tërësi ka mbetur pranë pretendimeve të theksuara si në dispozitivin e së njëjtës, duke i propozuar gjykatës që të pandehurën ta shpallë fajtores dhe t'i shqiptojë dënimin meritore në pajtim me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

E pandehura B. V., pasi që u njoftua me aktakuzën përkatësisht veprën penale e cila i vihet në barrë, e njëjta deklaroi se e pranoi fajësinë komform dispozitivit të aktakuzës.

Me që e pandehura në shqyrtimin e sotëm fillestar, vullnetarisht e pranoi fajësinë, gjykata konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, komform nenit 248, par. 1, i KPPK-ës, andaj gjykata nuk vazhdoi me administrimin e provave.

Prokurorja e shtetit Rozelida Hasani, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi: Duke u bazuar në faktin se e pandehura B. V., e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze edhe pas njoftimit të kësaj gjykate, lidhur me pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtën ta shpall fajtores dhe t'ia shqiptoj dënimin sipas ligjit. Me rastin e përcaktimit dhe llojit të dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, si dhe dënimin e shkaktuar të dëmtuarës KEDS-it .

E pandehura B. V., në mbrojtën e saj ka deklaruar: e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem, pendohem për të njëjtën, e njoftoj gjykatën që ka qenë hera e parë dhe e fundit që kam ra ndesh me ligjin, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera të kësaj natyre, meqë jam nënë e ... fëmijëve dhe jetoj vetëm nga të ardhurat personale që i marr si ..., andaj kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Duke u bazuar në aktakuzën përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet e pandehura, si dhe pranimin e fajësisë nga e njëjta, gjykata vërtetoi se te e pandehura qëndrojnë të gjitha elementet e kryerjes së veprës penale, lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 i KPRK-së, sipas aktakuzës me numër dhe datë të cekur si më lartë, për çka është edhe penalisht përgjegjëse, andaj të njëjtën e shpalli fajtores dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e matjes së dënimeve me burg dhe me gjobë e të kushtëzuara, si në dispozitiv të aktgjykimit, ndaj të pandehurës, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73,74,75 dhe 76 të

KPRK-ës. Ku si rrethana lehtësuese ka marrë për bazë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, meqë është nënë e katër fëmijëve, dhe jeton vetëm nga të ardhurat personale që i merr si arsimtare, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës KEDS-it – distribuimi në Gjilan.

Sipas bindjes së kësaj gjykate dënimet me burg dhe me gjobë e të kushtëzuara, sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës, dhe konsideron se edhe me këto dënime, do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, si dhe këto dënime do të ndikojnë në të pandehurën dhe personat potencial, ku jeton dhe vepron që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave tjera penale.

E dëmtuara KEDS-in në Gjilan, komfor nenit 463 të KPPK-ës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 par. 1 e lidhur me nenin 450 par. 1 nëpar. 2.6 të KPRK-ës .

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.630/16, më 20.10.2017

Sek.juridike,
Rafete Syla, d.v.

Gjyqtari i vetëm gjykues
Islam Thaçi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e pranimin të së njëjtit. Ankesa në kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.